



K.DH.SH.II.nr.104/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Shoqëria “...” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Xh.K, me bazë juridike, kundërvajtje doganore, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1753/18, të datës 17.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.10.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit, Shoqëria “...” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, e datës 07.06.2018, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative- Divizioni Fiskal, A.nr.1753/18, i datës 17.09.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, Shoqëria “...” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, ndërsa është lënë në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës nr. i datës 19.06.2018.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të anulohet aktgjykimi i atakuar dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës parë në rishqyrtim apo rivendosje, apo aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërsi si e bazuar, dhe paditësi të lirohet nga detyrimi i pagesës së gjobës në shumë prej 1,700.00€ për shkak të kryerjes së kundërvajtjes sipas nenit 276 par.1 nën paragrafi (k) i KDAK-së.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e organit të paditur nr. 01.3.2.2/335 i datës 19.06.2018, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, Shoqëria “....” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, të ushtruar ndaj aktvendimit nr. i datës 16.05.2018, të lëshuar nga Sektori për Kundërvajtje Doganore.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurit subjekti-tani paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ-Divizion Fiskal. Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor më dt.17.09.2020, si në vështrim të nenit 41 të LKA, në mungesë të përfaqësuesit të palës paditëse dhe në prani të përfaqësuesit të palës së paditur dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lenë në fuqi aktvendimin e organit të paditur, sipas theksimeve në arsyetim se: “Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata konstaton se në procedurën administrative gjendja faktike është vërtetuar drejt kur është nxjerr konkluzioni se paditësit i është hedhë posht ankesa e ushtruar kundër vendimit me nr. e datës 16.05.2018 si e ushtruar jashtë afatit, për arsye se subjekti në procedurë me datë 07.06.2018 ka parashtruar ankesë kundër vendimit nr. të datës 07.06.2018, ndërsa vendimin e komisionit për kundërvajtje doganore nr. e ka pranuar me postë me datën 24.05.2018, dhe në bazë të kalkulimit kalendarik të ditëve është konstatuar se paditësi e ka parashtruar ankesën jashtë afatit të dhënë në udhëzimin për ankesë dhe dispozitave ligjore për rivendosje të afatit në Doganën e Kosovës të cilën kërkesë e paditura me aktvendimin kontestues e ka refuzuar si të pa bazuar.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Kodit doganor dhe LPA, siç pretendohet në ankesë dhe as me shkelje të tjera të dispozitave të LKA dhe LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare, si në vështrim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar - aktvendimit të DK, nr. i datës 19.06.2018, të atakuar nga paditësi si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, e miraton si të drejtë dhe ligjor, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sepse, nga dëshmitë e administruara ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim. Gjithashtu, kolegji vlerëson se Organi administrativ, e në rastin konkret DK, ka shpallur paditësin përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes doganore për shkak se nuk ka deklaruar saktë kodin tarifor të mallit, dhe me këtë veprim i është shmangur taksave doganore gjithsejtë në shumë prej 4,630.04€, pra ka vepruar në këtë mënyrë me qëllim që të paguaj taksa doganore në vlerë më të vogël se nga ajo realja. Dogana e Kosovës- Komisioni për Kundërvajtje Doganore pas pranimi të kërkesës së subjektit Shoqëria “....” Sh.p.k. me seli në Prishtinë, ka konstatuar se kërkesa e palës është e ushtruar jashtë afatit ligjor, andaj ka vepruar si në dispozitiv të aktvendimit duke hedhur poshtë kërkesën e palës si të ushtruar jashtë afatit ligjor.

Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve ankimore, si dhe theksimet e tjera në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtën e refuzon si të pa bazuar dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse nuk dëshmohet se gabimisht është aplikuar e drejta materiale e po ashtu gjendja faktike e çështjes është vërtetuar në mënyrë të plotë në gjykatën e shkallës së parë dhe në organin përfundimtar të DK, se subjekti-paditësi ka ushtruar kërkesë në Doganën e Kosovës për rishqyrtimin e aktvendimit të Komisionit për Kundërvajtje Doganore e cila pasi ka bërë përlllogaritjen e ditëve kalendarike ka konstatuar se kërkesa është e ushtruar jashtë afatit ligjor, pasi që me datën 24.05.2018, subjekti ka pranuar aktvendimin me postë, ku nga kjo datë ka gëzuar të drejtën e ushtrimit të kërkesës për rishqyrtim të aktvendimit të lartcekur në vështrim të nenit 60 paragrafi 1 I Ligjit 05/L-087 për kundërvajtje, ku në këtë nen parashihet se afati i kundërshtimit është 8 ditë nga dita e marrjes së vendimit, e paditësi ka ushtruar kërkesë me datën 07.06.2018, që në bazë të dispozitave ligjore që janë në fuqi, kërkesa është ushtruar jashtë afatit ligjor.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
K.DH.SH.II.nr.104/22, me datë 06.10.2022

Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti